



KONTRATE SHITJE KUOTASH

Ne Kucove, sot ne daten 16.09.2005 (dymije e pese ), dite e premte ,para meje noteres Anila Bardhi, ne zyren e noterise ne lagjen "Ll.Pristi", u paraqiten personalisht pale per lidhjen e kesaj kontrate te cilet kane keto identitete:

PALE SHITESE: -Sokol Paço ,I biri I Thanas ,I datelindjes 29.09.1969 ,lindur dhe banues ne Kucove, lagja "11 Janari" ,per identitetin e te cilit u sigurova me deshmine e aftesise se mjetit me numer 801277 date 18.11.2003.

PALE BLERESE: -Klodian Doko ,I biri I Rrapo ,i datelindjes 28.07.1979 ,lindur ne Berat dhe banues ne Kucove, lagja "11 Shkurti" ,per identitetin e te ciles u sigurova me pasaporten me numer 1939584.

Shtetasit jane madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Ne perputhje me dispozitat ligjore nenin 47 te Ligjit nr. 7638 date 19.02.1992, nenin 705 te Kodit Civil, palet me vullnetin e tyre te lire, te plote dhe sinqerte lidhin kete kontrate duke bere keto deklarime dhe sipas ketyre kushteve :

Shitesi eshte ortak i shoqerise « Kucova » » ,shpk me seli ne Kucove, regjistruar si person juridik me vendim numer 18418 date 30.12.1997 te gjykates se rrethit Tirane. Ai zoteron ne kete shoqeri 10% te kapitalit te pergjithshem te kesaj shoqerme me nje vlere nominale prej 10.000 (dhjete mije)leke te reja . Te gjithë kapitalin qe ai ka ne shoqerine « Kucova » ai deklaroi se ia shet Z.Klodian Doko. Bleresi deklaroi se eshte dakort qe te bleje 10% te kapitalit qe ka Sokol Paço ne kete shoqeri me nje vlere prej 10.000 (dhjete mije)leke te reja .

Me nenshkrimin e kesaj kontrate blerisi Klodian Doko perfiton 10% te kapitalit te pergjithshem te shoqerise » Kucova » shpk me nje vlere nominale prej 10.000 (dhjete mije)leke te reja .

Kontrata u redaktua ne tre origjinale me permbajtje te njejte dhe pasi lexohet nenshkruahet pa verejtje.

Une noteria legalizoj redaktimin e saj dhe vertetoj autenticitetin e nenskrimeve.

PALA SHITESE

Sokol Paço

PALA BLERESE

KLODIAN DOKO

NOTERE

ANILA BARDHI